REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar
Primljeno/Prodato
Recieved/Delivery 07 . 12 . 2018 vitit god year

Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Količina Quantity
SKPMSHCK	7492/2018		111

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 342 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.

4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:
-Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës;
-Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe
-Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno / Prenato / Received / Delivery 07 - 12 - 201 8 vitit god year			
Organ./Njesia / Organ./Jedinica / Org./Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot.No:	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	7492/2018		1/13

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORT I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2017

Prishtinë, 2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 03

Funksioni i mbikëqyrjes.....03

Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....03

Fushat e mbikëqyrjes.....04

Raporti për mbikëqyrjen në Zyrën e Kryeministrit.....05

Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve.....07

Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit.....08

Procedurat disiplinore.....09

Procedurat e ankesave.....09

Procedurat e vlerësimit.....10

Procedurat e pushimeve.....10

Procedurat e transferimit.....10

Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara.....10

Pezullimi, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës.....11

Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....11

Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....12

Trajnimi i Nëpunësve Civil.....12

Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....12

Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....12

Shënimet/komentet për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....13

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI I KËSHILLIT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes, Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar „Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton „Planin e Mbikëqyrjes" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim të vitit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive për realizimin e objektivës sonë, duke u bazuar në „Pyetësorin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil'' kemi kryer monitorimin duke zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli gjatë zbatimit të mandatit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.

Në këtë kuadër, si pjesë e mbikëqyrjes janë përfshirë fushat:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2017

Kolegji gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Zyra e Kryeministrit, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 25.10.2018, në prezencë të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Formulari për të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës 2017 në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, periudhën tetor-dhjetor 2017;
- Vendimi Nr.prot:1140/2017 i datës 15.12.2017 për caktim të ushtruesit të detyrës;
- Vendimi Nr.prot:426/2017 i datës 29.05.2017 për caktim të ushtruesit të detyrës;
- Njoftim i datës 28.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi Nr.prot:207/2017 i datës 24.03.2017 për rikthim në pozitën e mëparshme;
- Vendimi Nr.prot:425/2017 i datës 29.05.2017 për rikthim në pozitën e mëparshme;
- Vendimi Nr.prot:117/2017 i datës 16.02.2017 për caktim të ushtruesit në detyrë;
- Vendimi Nr.425/2017 për rikthmin në pozitën e mëparshme;
- Lista e pozitave të lira për vitin 2017;
- Formulari i Planit Individual të Personelit i datës 27.10.2016;
- Vendim Nr.prot: 923/2016 i datës 09.12.2016 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi nr.prot.922/2016 i datës 09.12.2016 për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Konfirmim i datës 13.01.2017 për vazhdim të akt emërimit;
- Formulari i datës 11.01.2017 për vlerësimin e punës provuese;
- Kërkesë e datës 16.12.2016 për vlerësimin e punës provuese;
- Vendim Nr.497/2016 i datës 11.07.2016 për lejimin e pushimit të lehonisë; E-mail i datës 10.01.2017 bashkangjitur listën e pushimeve;
- Vendim nr.272/2016 i datës 29.04.2016 për delegim të kompetencave;
- Vendim nr.876/2017 i datës 21.09.2017 për pushim pa pagesë;
- Njoftim i datës 07.04.2017 për transferim në nivel drejtues;
- Marrëveshja e datës 23.03.2017 për transferim;
- Kërkesë e datës 22.03.2017 për transferim;
- E-mail i datës 22.03.2017;
- Vendimi i datës 24.03.2017 për transferim të përhershëm;
- Akt emërimi i datës 30.03.2017;
- Njoftim i datës 09.03.2017 për anulim të konkursit për pozitën „Drejtor i zyrës ligjore'';
- Vendim i datës 07.11.2017 për transferim të përhershëm;
- Kërkesë e datës 06.11.2017;
- Marrëveshje e datës 06.11.2017 për transferim;
- Vendim nr.1091/2017 i datës 01.12.2017 ndërprerje e marrëdhënies së punës-dorëheqje;
- Lista e trajnimeve të vitit 2017;
- Plani i trajnimeve i datës 21.01.2017;
- Vendimi nr.106/2017 i datës 13.02.2017 për pezullim parandalues;
- E-mail i datës 13.02.2017;

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

- Njoftim i datës 15.02.2017;
- Vendim nr.044/2016 i datës 26.01.2016 për pezullimin e dakorduar ;
- Vendim nr.226/2016 i datës 13.04.2016 për pezullimin e dakorduar;
- Vendim nr.245/2016 i datës 18.04.2016 për pezullimin e dakorduar;
- Vendim nr.979/2017 i datës 23.10.2017 për ndërprerje të marrëdhënies së punës;
- Lista e pagave e datës 01.11.2017 deri me datë 30.11.2017;
- E-mail zyrtar i datës 11.12.2017 për mungesë në punë;
- E-mail zyrtar i datës 22.12.2016, lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta, Interpretim nr.02/ZSP/1240 i Kërkesës për marrëveshjet për shërbime të veçanta;
- Kontratë Nr.261/2017 e datës 02.10.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.257/2017 e datës 02.10.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.129/2017 e datës 01.04.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.44/2017 e datës 01.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.43/2017 e datës 01.09.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.42/2017 e datës 01.09.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.45/2017 e datës 01.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.46/2017 e datës 01.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.72/2017 e datës 24.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.71/2017 e datës 01.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë Nr.47/2017 i datës 01.02.2017 për angazhimin e praktikantit;
- Kontratë e datës 09.03.2017 për asistente;
- Kontratë me nr. 186 e datës 04.01.2017 për konsulentë;
- Kontratë Nr.609/2 e datës 17.03.2017 për shërbime të veçanta;
- Kontratë Nr.609/3 e datës 17.03.2017 për shërbime të veçanta;
- Kontratë Nr.085/2 017 e datës 18.05.2017 për shërbime të veçanta;
- Kontratë Nr.2773/2 e datës 10.11.2017 për shërbime të veçanta;
- Marrëveshje nr.3164 e datës 13.11.2017 për shërbime të veçanta;
- Marrëveshje nr.3009 e datës 04.11.2017 për shërbime të veçanta;
- Marrëveshje nr.3008 e datës 01.11.2017 për shërbime të veçanta;
- Marrëveshje nr.3007 e datës 01.11.2017 për shërbime të veçanta.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, e vlerëson bashkëpunimin e treguar, përgatitjen e dokumenteve dhe informatat e ofruara nga udhëheqësja e personelit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës gjatë realizimit të vizitës me datë 25.10.2018.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në pyetësorin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar të gjeturat në vijim të raportit, si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, si në vijim:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me datë 25.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të datës 09.01.2013 të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, të plotësuar dhe ndryshuar me rregulloret përkatëse të miratuara nga Qeveria. Sipas deklarimit të zyrtares së personelit, në këtë institucion janë të punësuar 104 nëpunës civil, ndërsa në vitin 2017 kanë pasur 6 pozita të lira.

Gjatë vizitës monitoruese, Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e nëpunësve civil për pozitën „Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Politikave'', ''Zyrtar i Lartë për Koordinimin e Politikave'', ''Zyrtar i Lartë për Legjislacion'', ''Zyrtar i Lartë Ligjor'', dhe'' Drejtor për Qeverisje te Mirë'', dhe në bazë të vlerësimeve nuk ka gjetur shkelje pasi që dosjet e personelit janë të ruajtura dhe të kompletuara në pajtim me dispozitat e nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Në bazë të informatave të ofruara, është konstatuar që Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka pasur të caktuar 4 nëpunës si ushtrues të detyrës.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil gjatë shqyrtimit të dosjeve për ushtruesit e detyrës gjegjësisht vendimeve për caktimin e ushtruesit të detyrës, ka konstatuar të gjeturat në vijim:

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimin Nr.prot:1140/2017 për pozitën „Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik'', është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita: „Zyrtar i lartë për planifikim të politikave'' nga data 15.12.2017 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me Nr.prot:426/2017, për pozitën: ''Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa'', është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita: ''Zyrtari i lartë për Financa dhe Arkatar'' nga data 29.05.2017 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Me këto veprime Zyra e Kryeministrit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor për ushtruesin e detyrës si dhe për nëpunësin zëvendësues.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe menagjerin e personelit që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 36 dhe 37 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, për pozitat e lartcekura si dhe për çdo rast të caktimit të ushtruesit të detyrës apo të zëvendësimit të nëpunësit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit ka pasur të përgatitur planin për procedurat e rekrutimit.

Kolegji ka konstatuar se ky institucion ka pasur gjashtë (6) pozita të lira. Në këtë institucion janë zhvilluar katër (4) procedura të rekrutimit.

Kolegji ka analizuar dosjet e procedurës se rekrutimit për pozita: ''Zyrtar i Transportit'', „Zyrtar i Lartë Ligjor'', dhe „Zyrtar i Lartë për Planifikim Strategjik'', dhe është konstatuar se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar konform dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Kolegji për mbikëqyrje në bazë të dokumenteve të shqyrtuara ka konstatuar që Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2017 në periudha të ndryshme kohore, ka pasur të angazhuar gjithësejt 8 nëpunës me marrëveshje për shërbime të veçanta.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, për vitin 2017 ka pasur të angazhuar gjithësejt 8 nëpunës me marrëveshje për shërbime të veçanta, prej të cilëve 8 pozitat për të cilat janë angazhuar këta nëpunës, kanë qenë pozita të nëpunësve civilë. Kolegji si mostër ka marr kontratat për shërbime të vecanta për të gjitha pozitat e lartëcekura.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: ***„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës".***

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që të ndërmerr të gjitha veprimet për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe që për pozitat e nëpunësve civil, të mos angazhojnë nëpunës në bazë të kontratave për shërbime të veçanta por që plotësimi i vendeve të lira të punës të caktuara për nëpunës civil të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të dosjeve për marrëveshje për shërbime të veqanta dhe në bazë të informatave dhe dokumenteve të pranuara nga organi i punësimit, ka konstatuar që gjatë vitit 2017, Zyra e Kryeministrit, nuk ka zbatuar dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil me rastin e angazhimit të nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta për 43 pozitat për të cilat janë angazhuar këta nëpunës civilë.

Në lidhje me marrëveshjet e lartëcekura, Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur asnjë dëshmi për zhvillimin e procedurës së thjeshtësuar të rekrutimit për angazhimin e nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veqanta.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

Me këtë veprime Zyra e Kryeministrit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton angazhimin me „Marrëveshje për shërbime të veçanta" me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që të ndërmerr të gjitha veprimet e menjëhershme për eliminimin e shkeljeve të evidentuara dhe ndërprerjen e angazhimit të nëpunësve me „Marrëveshje për shërbime të veçanta" në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit në bazë të Vendimit me numër protokolli 923/2016 të datës 09.12.2016 i ka vazhduar mandatin e emërimit Komisionit Disiplinor. Sipas këtij vendimi konstatohet se Komisioni Disiplinor është i përbërë nga tre (3) anëtar të cilët kanë mandat dy (2) vjeçar dhe është themeluar konform nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në këtë institucion nuk është zhvilluar asnjë procedurë disiplinore dhe nuk është dhënë asnjë masë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit në bazë të Vendimit me numër protokolli 922/2016 të datës 09.12.2016 i ka vazhduar mandatin e emërimit Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Sipas këtij Vendimi, konstatohet se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i përbërë nga tre (3) anëtar të cilët kanë mandat dy (2) vjeçar dhe është themeluar konform nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave janë parashtruar dy (2) ankesa, dhe si kopje janë marr Vendimi me numër 01/2016 i datës 16.02.2016, dhe Vendimi me numër 02/2016 i datës 22.11.2016 ku është konstatuar që këto dy vendime janë marr në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me procedurën e ankesave.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil. Zyra e Personelit në Zyrën e Kryeministrit me datë 18.11.2017 ka përcjell shkresën zyrtare tek menaxhmenti me njoftimin për të përfunduar vlerësimet e rezultateve të punës, për nëpunësit civil në ZKM, deri me datë 31.12.2017. Me datë 16.01.2018 Zyra e Personelit në Zyrën e Kryeministrit ka hartuar raportin e përgjithshëm të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2017 për të gjithë nëpunësit e Zyrës së Kryeministrit, duke përfshirë edhe nëpunësit civil të agjencive që janë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në kopje fizike dhe elektronike. Nëpunësit civil kanë realizuar pushimin mjekësor në 33 raste, dhe në bazë të dosjeve të kontrolluara, konstatohet që nëpunësit civil i kanë sjell dëshmitë mjekësore ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Kolegji ka konstatuar se një (1) nëpunëse civile ka realizuar pushim të lehonisë, dhe në bazë të Vendimit për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë me numër Nr.497/2016 të datës 11.07.2016 është konstatuar se pushimi është miratuar në pajtim me legjislacionin përkatës për pushimin e lehonisë. Poashtu ka pasur edhe një pushim pa pagesë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, gjatë vitit 2017 ka pasur 2 (dy) transferime të përhershme.

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe me legjislacionin për shërbimin civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, ka të punësuar 104 nëpunës civil, prej tyre 98 janë shqiptar, 2 nëpunës janë të përkatësisë etnike serbe, 1 nëpunës i përkatësisë etnike turke,1 nëpunës është i përkatësisë etnike boshnjake, 1 nëpunës i përkatësisë etnike malazeze dhe 1 nëpunës është i përkatësisë etnike gorane.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar se:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 104 nëpunësve civil të punësuar në Zyrën e Kryeministrit, 50 nëpunës janë meshkuj, ndërsa 54 nëpunëse të punësuara janë femra.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit ka të punësuar 104 nëpunës civil, dhe ka të punësuar vetëm një person me nevoja të veqanta, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që *„Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor''*

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me nevoja të veqanta.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, një nëpunës civil e ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të dorëheqjes, dhe ka pasur një rast të përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të vdekjes së nëpunësit civil.

Kolegji ka shqyrtuar dosjen e nëpunësit civil të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me rastin e dorëheqjes dhe ka konstatuar se për këtë nëpunës civil ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

Gjatë vitit 2017, tre (3) nëpunësve civil i është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive të ofruara, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, nuk ka pasur asnjë nëpunës civil i cili e ka mbajtur pozitën e nëpunësit civil dhe po ashtu në të njëjtën kohë e ka ushtruar detyrën e funksionarit publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive të ofruara dhe informatave të pranuara nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, ka pasur një nëpunës ndaj të cilit është zhvilluar procedurë penale dhe i njëjti është pezulluar në pajtim me ligjin.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, Plani i trajnimeve, është përgatitur dhe është proceduar në DASHC/MAP me datë.

Në bazë të dëshmive të ofruara, konstatohet që nëpunësit civil marrin pjese në trajnime në bazë të ftesave nga IKAP, ndërsa gjate vitit 2017 nëpunësit civil nuk kane marre pjesë në trajnime jashtë vendit. Evidenca e trajnimeve të nëpunësve civilë mbahet në formë elektronike.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, Kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHTESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Zyrën e Kryeministrit, evidenca e vijimit në punë mbahet në formë elektronike.

Po ashtu është konstatuar që nëpunësve civil i është bërë kompensimi i përcaktuar me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit, plotësisht i ka zbatuar rekomandimet e Këshillit, të dhëna në vitin 2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Zyrën e Kryeministrit për vitin 2017 ka arritur të konstatoj katër (4) të gjetura dhe ka dhënë katër (4) rekomandime idhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Zyrës së Kryeministrit, që ***të gjeturat dhe rekomandimet*** e dhëna në këtë raport t'i adresojnë dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojnë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lulzim ALIAJ
Kryetar i Kolegjit

Zyle GOJNOVCI
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- *Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;*
- *Menaxherit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit;*
- *Arkivit të KPMSHCK.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë", Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
https://kpmshc.rks-gov.net/